



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 30.3.2023

Nr: 218

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

KTHIMIN PËR KORRIGJIM TË DOKUMENTACIONIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË TË KËSHILLIT BASHKIAK, BASHKIA VLORË, TË DEPOZITUAR NGA PARTIA “LËVIZJA E LEGALITETIT”, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenit 67, nenit 72 dhe nenit 73, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe udhëzimit nr. 1, datë 18.1.2023 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”,

V Ë R E J:

Partia “Lëvizja e Legalitetit”, me vendimin nr. 134, datë 8.3.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Lëvizja e Legalitetit”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Në mbështetje të neneve 67 e 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, partia “Lëvizja e Legalitetit” ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak.

Në bazë të nenit 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikoi listat shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak të partisë “Lëvizja e Legalitetit” dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur. Në përfundim të procesit të verifikimit paraprak u konstatuan mangësi dhe mospërbushje të dokumentacionit si më poshtë:

Data: 30.3.2023 Nr: 218
Ora: 11:00



“Për kthimin për korrigjim të dokumentacionit të listës shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak Bashkia Vlorë, të depozituar nga partia “Lëvizja e Legalitetit”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

- Konstatohet se disa prej emrave të listës shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak të partisë “Lëvizja e Legalitetit”, figurojnë në listat shumemërore të një partie tjetër.
- ID e deklaruara në formularë nuk janë të sakta.

Në zbatim të nenit 73, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dokumentacioni i depozituar i kthehet për korrigjim, subjektit zgjedhor partia “Lëvizja e Legalitetit”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72 dhe 73, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2023 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”,

V E N D O S:

1. Kthimin për korrigjim, për gjetjet e renditura më sipër, të dokumentacionit për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak, Bashkia Vlorë, të partisë “Lëvizja e Legalitetit”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Dokumentacioni i korrigjuar të depozitohet brenda datës 31.03.2023.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tri) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI